

## UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 712, datë 19.9.2024

### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 28, DATË 16.10.2023, “PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR TRANSFERIMIN NGA ARSIMI I PËRGJITHSHËM (GJIMNAZ) NË ARSIMIN PROFESIONAL DHE ANASJELLAS”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 20, pika 5, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

#### UDHËZOJMË:

1. Në udhëzimin nr. 28 datë 16.10.2023, “Për kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz) në arsimin profesional dhe anasjellas”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Pika 1, e nenit 4, ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Transferimi i nxënësit nga gjimnazi në arsimin e mesëm profesional dhe anasjellas, lejohet gjatë ndjekjes së klasës së 10-të, si edhe kur nxënësi ka përfunduar klasën e dhjetë. Ky rregull vlen edhe kur nxënësi ka ndjekur arsimin e përgjithshëm parauniversitar jashtë vendit.”;

b) Pika 3, e nenit 4, ndryshon si më poshtë vijon:

“3. Nxënësit, të cilët transferojnë studimet nga jashtë shtetit në Republikën e Shqipërisë, gjatë klasës së 10-të ose pasi kanë mbaruar klasën e 10-të, në arsimin e mesëm të përgjithshëm ose në arsimin e mesëm profesional, duhet të paraqesin programin mësimor të ndjekur në atë shtet, të përkthyer dhe të noterizuar me vulë apostile.”;

c) Në shkronjën “d”, të pikës 2, të nenin 5, togfjalëshi “*gjatë 3-mujorit të parë*” zëvendësohet me togfjalëshin “*gjatë klasës së 10-të*”;

d) Pika 3, e nenit 5, ndryshon si më poshtë vijon:

“3. Nxënësve që transferohen nga gjimnazi në arsimin profesional, gjatë ndjekjes së klasës 10 ose në përfundim të klasës së 10-të, shkolla iu krijon mundësi për të plotësuar mangësitë teorike dhe praktike në kulturën profesionale. Periudha e plotësimit të mangësive është dy muaj, për nxënësit që transferohen në përfundim të klasës së 10-të dhe jo më shumë se dy muaj, për nxënësit që transferohen gjatë klasës së 10-të (në varësi të periudhës kohore të munguar në arsimin profesional).

Gjatë periudhës së plotësimit të mangësive, mësuesi kujdestar, në bashkëpunim me mësuesit e teorisë dhe praktikës profesionale përkatëse, përgatitin një “plan për mbështetjen teorike/praktike” të nxënësit të transferuar.”

e) Pas pikës 3, të nenit 6 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me përmbajtje si më poshtë:

“3/1. Përcaktimet e këtij udhëzimi fillojnë efektet për vitin shkollor 2024–2025 për transferimet nga gjimnazi në arsimin profesional dhe anasjelltas, vetëm për nxënësit që bëjnë transferime gjatë ndjekjes së klasës së dhjetë.”;

“3/2. Për nxënësit që kanë përfunduar klasën e 10-të (dhjetë) në gjimnaz dhe kërkojnë të vazhdojnë klasën e 11-të (njëmbëdhjetë) në arsimin profesional dhe anasjelltas, i fillon efektet në vitin shkollor 2025–2026.”

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar,

drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, ofruesit e arsimit dhe formimit profesional dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
**Blendi Gonxhja**

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Ogerta Manastirliu**